

ENTROPY

The lyrics / hymns of the album, in Albanian, Greek and English, followed by explanatory texts in Albanian and English

01. Kurrë nuk po merret vesh

(Nga *Madhështimet* e Paraqitjes së Krishtit në Tempull - Përhasjes)

(Από τα *Μεγαλυνάρια* της Υπαπαντής του Χριστού)

(From the *Magnificat* of the Presentation - Hyrapante)

Kurrë nukë merret vesh, as prej engjëjsh, as prej nesh, ajo që po ngjan me ty, Nën' e Virgjër, Shën Mari. Simeoni priti sot, Shpëtimtarin në pëqi, Zotin e kanuneve, krijëtarin plot me hir. O Hyjlindëse Mari, shpres' e të krishterëve, mbroji edhe ruaji gjithë nderonjësit e tu. Gjindj' e njerëzve kudo o Mari të lavdëron, dhe me besë të këndon, Nën' e Zotit, Perëndi.¹

Ακατάληπτόν ἐστι, τὸ τελούμενον ἐν σοί, καὶ Ἀγγέλοις καὶ βροτοῖς, Μητροπάρθενε ἀγνή. Ἀγκαλίζεται χερσίν, ὁ Πρεσβύτερος Συμεὼν, τὸν τοῦ νόμου Ποιητὴν, καὶ Δεσπότην τοῦ παντός. Θεοτόκε ἡ ἐλπίς, πάντων τῶν Χριστιανῶν, σκέπε φρούρει φύλαττε, τοὺς ἐλπίζοντας εἰς σέ. Γένος ἅπαν τῶν βροτῶν, μακαρίζει σε Ἄγνή, καὶ δοξάζει σε πιστῶς, ὡς Μητέρα τοῦ Θεοῦ.

It will be never understood what is accomplished inside you, both of angels and of humans, virgin and chaste Mother. Symeon the Elder embraces in his arms the Maker of the law and the Master of everything. Mother of God, hope of all Christians, protect, watch over and guard all those who rely in you. The whole race of humans beautifies you, o Chaste, and faithfully glorifies you as the Mother of God.

Sipas kalendarit liturgjik të Kishës së Lindjes, më datë 2 shkurt kujtohet Hyrja në Tempull e Zotit Jezu Krisht. Në traditën judaike, fëmija mashkull i parëlindur, 40 ditë pas lindjes çohet në Tempull për t'u paraqitur përpara Zotit. *Madhështimi* fillon me një habi: “nuk po merret vesh”, nuk kuptohet si është e mundur që, një vajzë e virgjër bëhet nënë! Ky është qëndrimi i teologjisë së Kishës Ortodokse në lidhje me Lindjen e Krishtit: nuk mund të shpjegohet a provohet me argumente njerëzore, thelbin Hyjnor nuk e nxë arsyeja njerëzore. Më pas, himnografi përshkruan se si Simeoni, Kryepriifti i Tempullit

¹ *Kremtore e Kishës Ortodokse*, përkthyer në shqip nga Theofan S. Noli, Boston, Massachusetts, 1947, fq. 584.

të Solomonit, mori Jezuin në prehër, duke bashkuar, kështu, Dhiatën e Vjetër me të Renë. Në emër të të gjithë të krishterëve, himnografi kërkon mbrojtjen e Shën Marisë, duke e siguruar se të gjithë e njohin si nënë të Zotit.

According to the liturgical calendar of the Church of East, on February 2nd is commemorated the Presentation on the Temple of the Lord Jesus Christ. Following the Judaic tradition, 40 days after its birth, the firstborn male baby was brought in the Temple, to be presented to God. The *magnificat* starts by wondering: “it is not understandable”, it cannot be understood how it is possible that, a virgin girl becomes a mother! This is the position of the Orthodox theology regarding the Birth of Christ: it cannot be explained or be proved through human arguments, the Divine essence cannot be conceived by the human reason. Latter, the hymnographer explains that Symeon, the Archpriest of the Temple of Solomon, took Jesus in his lap, thus uniting the Old Testament with the New. On the name of all the Christians, the hymnographer is asking for the protection of the Virgin Mary, assuring her that everybody recognizes her as the mother of God.

02. Eni shihni

(Ndenjësores e Mëngjesores së Krishtlindjeve)

(Κάθισμα του Ὁρθρου των Χριστουγέννων)

(*Kathisma* of the Christmas' Mattins)

Eni shihni besërisht, ku është lindur Zoti Krisht; le t'i biem gjithë pas, atje ku ylli udhëton, bashkë me Magët, mbretërit e Lindjes. Ëngjëjtë po e himnojnë pa pushim, barinjët plot me gaz, u bien fyejve, dhe lavdërojnë të lindurin në shpellë prej Kryezonjës, dhe Virgjëreshës, në Betlehem të Judesë.²

Δεῦτε ἴδωμεν πιστοί, ποῦ ἐγεννήθη ὁ Χριστός, ἀκολουθήσωμεν λοιπὸν ἔνθα ὁδεύει ὁ ἀστὴρ, μετὰ τῶν Μάγων Ἀνατολῆς τῶν Βασιλέων. Ἄγγελοι ὑμνοῦσιν, ἀκαταπαύστως ἐκεῖ. Ποιμένες ἀγραυλοῦσιν, ᾠδὴν ἐπάξιον: Δόξα ἐν ὑψίστοις λέγοντες, τῷ σήμερον ἐν Σπηλαίῳ τεχθέντι, ἐκ τῆς Παρθένου, καὶ Θεοτόκου, ἐν Βηθλεὲμ τῆς Ἰουδαίας.

Come, believers, let us see where Christ has been born, let us follow where the star guides, together with the Magi, kings of the East. Angels sing praises without ceasing. Shepherds play their flutes offering the fitting hymn, saying: Glory in the highest to him who has been born today in a cave from the Virgin and Mother of God, in Bethlehem of Judea.

Himnografi fton gjithë njerëzimin, jo vetëm besimtarët, të afrohen e të shohin vendin ku lindi Krishti. Brenda stallës, në një grazhd, pranë kafshëve, larg njerëzve dhe pallateve, lindi Mbreti i botës dhe Shpëtimtari. Mbretëria e Krishtit dhe e dashurisë u ndërtua mbi muret e thjeshtë të një vendi aspak fisnik. Pamjen që përshkruan ndenjësores e shohim në çdo ikonë bizantine të Lindjes së Krishtit, teksa ylli, Mbretërit e urtë (Magët), engjëjt që himnojnë dhe barinjët tregojnë udhën për tek grazhdi. Himnografi fton, po ashtu, njerëzimit të lavdërojnë Lindjen e shenjtë, teksa saktëson vendin ku ndodhi ngjarja: në Betlehem të Judesë.

The hymnographer is inviting all humans, not only the believers, to approach and see the place where was Christ born. Into a barn, in a crib, close by the animals, far from humans and the palaces, the King of the world and the Savior was born. The Kingdom of Christ and of love was founded on the modest walls of a humble place. The image that is described by the *kathisma* can be seen in each byzantine icon of the Birth of Christ, while the star, the wise Kings (the *Magi*), the angles that laud and the shepherds show the way toward the crib. The hymnographer is also inviting humanity to glorify

² *Kremtore e Kishës Ortodokse*, përkthyer në shqip nga Theofan S. Noli, Boston, Massachusetts, 1947, fq. 430.

the holy Birth, while making sure the location where it took place: in Bethlehem of Judea.

03. Lavirja

(Ndenjësores e Mëngjesores së të Mërkurës së Madhe)

(Κάθισμα του Ὁρθρου της Μεγάλης Τετάρτης)

(Kathisma of the Holy Wednesday Mattin)

Lavirja me vajtim, o i dhembshur, të lutej, dhe këmbët besërisht, po t'i fshinte me flokët, dhe thellazi po psherëtin, dhe thërriste me lot në sy: Mos më neverit, mos më përbuz o i mirë, prit më se po vij, plot me pendim dhe shpëtomë, o Zot i mëshirave.³

Ἡ Πόρνη ἐν κλαυθμῶ, ἀνεβόα οἰκτίρμον, ἐκμάσσουσα θερμῶς, τοὺς ἀχράντους σου πόδας, θριξὶ τῆς κεφαλῆς αὐτῆς, καὶ ἐκ βάθους στενάζουσα. Μὴ ἀπόση με, μηδὲ βδελύξη Θεέ μου, ἀλλὰ δέξαι με, μετανοοῦσαν, καὶ σῶσον, ὡς μόνος φιλόανθρωπος.

The harlot, while lamenting and crying, o Merciful, and eagerly wiping your immaculate feet with her hair, was moaning from the depth of her heart: Do not despise me, do not repulse me, my God, but accept me, since I am repented, and save me, for you are the only benevolent.

Tema është marrë nga Ungjilli sipas Lukës, 7: 36-50 (e ngjashme edhe me Ungjillin sipas Mateut 26: 9-13 dhe atë sipas Markut 14: 3-9), ku tregohet ngjarja e mëposhtme: Një farise ftoi Jezuin në shtëpinë e tij. Jezuit pranoi dhe, si gjithmonë, filloi të predikonte. Aty pari ndodhej një grua e njohur për jetën imorale që bënte, e cila, e prekur nga fjalët e Krishtit, ia lau këmbët me lot, ia fshiu me flokët e saj dhe ia leu me miro të shtrenjtë. Krishti i dha faljen e mëkateve dhe, duke iu drejtuar fariseut dhe të pranishmëve, tha: “Kësaj i falen mëkatet e shumta, sepse dashuroi shumë” (Luka 7: 47). Himmografi, i cili përfaqëson besimtarët, vendos veten në vendin e lavires, duke i kërkuar Perëndisë falje për mëkatet e kryera dhe shpëtim.

The theme is coming from the Gospel according to Luke, chapter 7, verses 36-50 (similar with that in the Gospels according to Mathew 26: 9-13 and Mark 14: 3-9), where the following story is narrated: A Pharisee invited Jesus into his home. Jesus accepted and, as always, he started to preach. Close by was a woman who was famous for her immoral life, who, moved by the preaching of Christ, washed his feet with her tears, wiped them with her hair and anointed them with holy myrrh. Christ forgave her sins and, talking to the Pharisee and to those present, said: “Her many sins are forgiven, for she loved much” (Luke 7: 47). The hymnographer, who represents the believers, places himself in the position of the harlot, asking forgiveness by God for his multiple sins, and salvation.

³ *Triodi dhe Pesëdhjetorja*, përkthyer në shqip nga Theofan S. Noli, Boston, Massachusetts, 1947, fq. 168.

04. Zoti është bashkë me ne

(Nga shërbesa e Pasdarkës së Madhe)

(Από το Μεγάλο Απόδειπνο)

(From the service of the Great Compline)

Zoti është bashkë me ne, dijeni o kombe se jeni të mundur, se Zoti është bashkë me ne.

Dëgjojeni anë e mbanë dheut, se Zoti është bashkë me ne.

Do t'i kemi besim, se Ai na shenjtëron, se Zoti është bashkë me ne.⁴

Μεθ' ἡμῶν ὁ Θεός, γνῶτε ἔθνη καὶ ἠττᾶσθε, ὅτι μεθ' ἡμῶν ὁ Θεός.

Ἐπακούσατε ἕως ἐσχάτου τῆς γῆς, ὅτι μεθ' ἡμῶν ὁ Θεός.

Καὶ εἰάν ἐπ' αὐτῷ πεποιθῶς ὦ, ἔσται μοι εἰς ἀγίασμόν, ὅτι μεθ' ἡμῶν ὁ Θεός.

God is with us, know it you nations and be submissive, for God is with us.

Hear it to the ends of the earth, for God is with us.

And if I should trust in Him, He shall be to me for a sanctuary, for God is with us.

Himni (në variantin e tij të gjatë) është frymëzuar nga kapitulli 8 dhe 9 i librit të Isaisë, Dhiata e Vjetër. I gjithë libri i Isaisë është një thirrje e profetit drejtuar popullit të izraelit për t'u kthyer tek Zoti, i cili është i vetmi që ka fuqi të dhurojë shpëtim. Në jetën liturgjike të krishterimit, vargjet e kënduara në Pasdarkën e Madhe vendosen në kontekstin e betejës shpirtërore të çdo të krishteri, i cili do të gjejë shpëtim vetëm nëpërmjet besimit dhe adhurimit të Zotit.

The hymn (in its long form) has been inspired by the book of Isaiah, chapter 8 and 9, from the Old Testament. The whole book of Isaiah is a call of the prophet toward the people of Israel, inviting them to turn back to God, who is the only one that has the power to donate salvation. In the Christian liturgical life, these verses, which are sung during the Great Compline, are placed in the context of the spiritual life for each Christian, who will find salvation only through faith and by worshiping God.

⁴ *Triodi dhe Pesëdhjetorja*, përkthyer në shqip nga Theofan S. Noli, Boston, Massachusetts, 1947, fq. 31.

05. O bukuri me nam

(Hyjlindësore, nga Himni Akathist)

(Θεοτοκάριον, από τον Ακάθιστο Ύμνο)

(Hymn to the Virgin, from the Akathist Hymn)

*O bukuri me nam, o virgjëri pa cen, o drit' e diellit, o hën' e qiellit, shën Gabrieli kur të pa, çuditej dhe të thërriste: Si të të lavdëroj, o Mari o Hyjlindëse? Ç'këngë të këndoj për ty? Nuk e di dhe kërkoj më kot. Pra them sikundër jam porositur: Gëzohu, Virgjëreshë hirplotë!*⁵

Τὴν ὠραιότητα τῆς Παρθενίας σου, καὶ τὸ ὑπέρλαμπρον τὸ τῆς ἀγνείας σου, ὁ Γαβριὴλ καταπλαγεῖς, ἔβόα σοι Θεοτόκε· Ποῖόν σοι ἐγκώμιον, προσάγαγω ἐπάξιον, τί δὲ ὀνομάσω σε; ἀπορῶ καὶ ἐξίσταμαι. Διὸ ὡς προσετάγην βοῶ σοι· Χαῖρε, ἡ Κεχαριτωμένη.

Gabriel saw the beauty of your virginity and the brilliance of your chastity, was astonished and cried to you, Mother of God: "What praise is worthy to you? How should I call you? I am amazed and I wonder... That is why I will call you the way I was instructed: Hail to you, who are full of grace"!

Në çastin e Ungjillëzimit, kur Gabrieli ishte caktuar t'i thoshte Virgjëreshës Mari se ishte zgjedhur, mes grave, të lindte Shpëtimtarin, engjëlli u mahnit nga bukuria e saj fizike dhe shpirtërore. Fjalët e tij, sipas Ungjillit, ishin: "Gëzohu, hirplotë, Zoti është me ty, dhe e bekuar je ti në mes të grave". Ky çast, i kthyer në himn, këndohet në fund të shërbesës së Himnit Akathist.

At the moment of the Annunciation, when Gabriel was appointed to tell the Virgin Mary that she was chosen among all women to give birth to the Savior, the angel was astonished by her physical and spiritual beauty. His words, according to the Gospel, where: "Hail, full of grace, the Lord is with thee, blessed art thou amongst women". This moment, turned into a hymn, is sung at the end of each service of the Akathist Hymn.

⁵ *Triodi dhe Pesëdhjetorja*, përkthyer në shqip nga Theofan S. Noli, Boston, Massachusetts, 1947, fq. 62.

06. Kyrie Eleison

Mëshiro o Zot.

Κύριε ἐλέησον.

Lord have mercy.

Është lutja më e shkurtër e trashëguar që nga koha e Apostujve, e cila përsëritet më shpesh nga çdo lutje tjetër në jetën e krishterë. Veç kërkesës që besimtari i drejton Zotit për falje, vetvetiu nënkupton dhe vetëdijen e besimtarit se është mëkatar, por dhe shpall se cili është Zot për të.

It is the shortest prayer, deriving from the time of the Apostles, which is repeated more than any other prayer in the Christian life. Besides being a request of the believer toward God for forgiveness, spontaneously it implies the conscience of the believer that he is a sinner, at the same time confirming who is God for him.

07. Krishti u ngjall

(Tropari i Pashkës)

(Τροπάριον του Πάσχα)

(Troparion of Easter - Pascha)

*Krishti u ngjall së vdekurësh, me vdekje, vdekjen shkeli, edhe të varrosurve jetën u fali.*⁶

Χριστὸς ἀνέστη ἐκ νεκρῶν, θανάτῳ θάνατον πατήσας, καὶ τοῖς ἐν τοῖς μνήμασι, ζωὴν χαρισάμενος.

Christ is risen from the dead, trampling death by death, and to those in the tombs bestowed life.

Quhet *tropar*, një fjalë që në greqisht do të thotë “këngë triumfale”, teksa *pashka* është një tjetërsim i fjalës hebraike *peshah*, që do të thotë *kalim*. Ashtu si judenjtë, edhe të krishterët kujtojnë Kalimin; të parët, kalimin nga Egjipti në Kanaan (Tokën e Premtuar), kurse të dytët kalimin nga vdekja në jetë. Ky është triumfi dhe fitorja: Krishti i ngjallur sjell jetë të përjetshme dhe shpëtim për njerëzimin. *Tropari i Pashkës* është një himn i shkurtër, i cili këndohet në çastin kur prifti / peshkopi, në Meshën e Pashkës, në mesnatë, u thotë besimtarëve: “Krishti u Ngjall!” Ky është tropari më i njohur për të krishterët e Lindjes.

It is called *troparion*, a word that in Greek means “triumphal song”, while *pascha* is a transformation of the Hebrew *peshah*, which is the *Passover*. Like the Jews, also the Christians commemorate the Passover, the firsts the one from Egypt in Kanaan (the Promised Land), the later the one from death to life. That is the triumph, and the victory: the resurrected Christ brings eternal live and salvation to all humanity. The *Troparion of Pascha* is a short hymn that is sung at the moment when the priest / bishop, on the Easter Mass, at midnight, chants to the believers: “Christ is Risen”. This one is the most known hymn for the Easter Christians.

⁶ *Libër i shërbesave të shenjta*, grup përkthyesish, botim i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Tiranë 1994, fq. 248.

8. Agni Parthene / Zonjë, virgjëreshë e kulluar

(Nga Shën Nektari i Egjinës)

(Από τον Άγιο Νεκτάριο Αιγίνης)

(By St. Nektarios of Aegina)

Zonjë virgjëreshë e kulluar, Hyjlindëse e panjollëshme;

Gëzohu nuse e panusëruar.

O Virgjëreshë, Nënë Mbretëreshë, dhe shumë e lavdishme;

Gëzohu nuse e panusëruar.

O më e larta se qiejt, o më e ndritshme se rrezet;

Gëzohu nuse e panusëruar.

O gëzim i valleve virgjërore, o më larta se engjëjt;

Gëzohu nuse e panusëruar.

O më e ndritshme se qiejtë, o më e pastër se drita;

Gëzohu nuse e panusëruar.

Më e shenjta se të gjitha ushtritë qiellore;

Gëzohu nuse e panusëruar.⁷

Άγνη Παρθένε Δέσποινα, Ἄχραντε Θεοτόκε,

Χαῖρε Νύμφη Ἀνύμφευτε.

Παρθένε Μήτηρ Ἄνασσα, Πανένδροσέ τε πόκε,

Χαῖρε Νύμφη Ἀνύμφευτε.

Ἵψηλοτέρα οὐρανῶν, ἀκτίνων λαμπρότερα,

Χαῖρε Νύμφη Ἀνύμφευτε.

Χαρά Παρθενικῶν Χορῶν, Ἀγγέλων ὑπερτέρα,

Χαῖρε Νύμφη Ἀνύμφευτε.

Ἐκλαμπρότερα οὐρανῶν, φωτὸς καθαρωτέρα,

Χαῖρε Νύμφη Ἀνύμφευτε.

Τῶν οὐρανίων στρατιῶν, πασῶν ἁγιωτέρα,

Χαῖρε Νύμφη Ἀνύμφευτε.

O pure and virgin Lady, o spotless Theotokos;

Rejoice, O unwedded Bride!

O Virgin Queen and Mother, o dewy Fleece most sacred;

Rejoice, O unwedded Bride!

O height transcending heaven above, O beam of light most radiant;

Rejoice, O unwedded Bride!

⁷ *Libër shërbesash*, grup përkthyesish, botim i Akademisë Teologjike “Ngjallja e Krishtit”, Durrës, Albania, 1995.

O joy of chaste and virgin maids, surpassing all the angels;
Rejoice, O unwedded Bride!
O brilliant light of heaven above, most clear and most radiant;
Rejoice, O unwedded Bride!
Commanding Chief of heavenly hosts, O holiest of holies;
Rejoice, O unwedded Bride!

Himni “Zonjë, virgjëreshë e kulluar” është një himn jo liturgjik. Është shkruar dhe kompozuar nga Shën Nektari i Egjinës, 1846-1920. Sipas traditës, Shën Maria iu shfaq Nektarit dikur në shek. XIX dhe i kërkoi t’i thurte një këngë, siç nuk ia kishte thurur askush aq bukur, një këngë që do ta këndonin edhe engjëjt në qiell. Dhe Nektari e bëri...

This is a non liturgical hymn, written and composed by Saint Nektarios of Aegina, 1846-1920. According to the tradition, the Virgin Mary appeared to Nektarios, sometime during the 19th century, and asked him to make her a song, something that nobody ever had done, that even the angels in Heaven would chose to sing it. And Nektarios did it...

*All lyrics (hymns) translated into English from the original in Greek by Sokol Çunga.
All the explanatory texts of the lyrics prepared by Sokol Çunga.*



eda zari

www.eda-zari.com